

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Driton Muharremi, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Mejreme Memaj, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.M. e R.K., që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, duke vendosur përkritazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve av.A.P. dhe av.A.TH., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.22/2018, të dt.22.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.18.10.2018, morri këtë:

## AKTGJYKIM

I.Me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve F.M. e R.K., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.22/2018, të dt.22.06.2018, sa i përket vendimit mbi dënimin ashtu që Gjykata e Apelit, të akuzuarve për veprën penale F.M. e R.K., për veprën penale në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 par.1 e në lidhje me nenin 31 të KPRK, e më afër të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit, dënimet e shqiptuara me gjobë prej nga 200(dyqind)Euro, i merr si të vërtetuara, dhe të akuzuarve iu shqipton dënimin me burgim secilit në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do t'iu llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe paraburgim prej dt.03.11.2017, gjer me dt.22.06.2018. Dënimin e shqiptuar me gjobë të akuzuarit detyrohen ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse të njëjtin nuk e paguajnë në afatin e caktuar, dënimi i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 (njëzet)Euro, do të llogaritet një ditë burgim.

II.Në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

## Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prizren, PKR.nr.22/2018, të 22.06.2018, të akuzuarit F.M. e R.K., që të dy nga Prizreni, janë shpallur fajtor për veprën penale të kryer në bashkëkryerje blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge në bashkëkryerje nga neni 273 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK, për të cilën veprë penale janë gjykuar: i akuzuari F.M., me dënim me gjobë në lartësi prej 200(dyqind)Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimi me gjobë do të zëvendësohet një ditë burgim dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.03.11.2017 deri me dt.22.06.2018.

I akuzuari R.K., me dënim me gjobë në lartësi prej 200(dyqind)Euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet një ditë burgim dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy)vite, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.03.11.2017 deri me dt.22.06.2018.

Të akuzuarve u është konfiskuar sasia e narkotikut në peshë prej 66.36gram.

Janë obliguar të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajnë paushallin në lartësi secili prej nga 50Euro, si dhe secili prej nga 50Euro, në emër të Fondit për kompensimin e viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij, aktgjykimi ankesë ka ushtruar:

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., av.A.P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, vendimit lidhur me sanksionet penale dhe vendimeve të tjera, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, si të bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit R.K., av.A.TH., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë në tërësi, dhe lëndën penale ta kthej në rigjykim dhe vendim apo ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.404/2018, të datës 10.09.2018, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësve të akuzuarve F.M. e R.K., av.A.P. e av.A.TH., ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP të Kosovës, ka caktuar seancën e kolegjit, në të cilën morën pjesë nga Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, kryeprokurori Haxhi Derguti, mbrojtësit e të akuzuarve av.A.P. dhe av.A.TH., ndërsa kanë munguar të akuzuarit, për të cilët mbrojtësit e tyre, kanë deklaruar se ata kanë qenë të njoftuar për seancën e kolegjit, mirëpo, për arsye personale nuk kanë mundur të marrin pjesë dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.4 të KPP.

Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KP të Kosovës, vlerësoi ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, si dhe të sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit, shqyrtoi dhe vlerësoi shkresat e lëndës, dhe gjeti:

Ankesat e mbrojtësit të akuzuarve F.M. e R.K., janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.K., në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 3 të KPP, se nuk është provuar nga asnjë dëshmitarë shpërndarja apo shitja me dashje e narkotikut si element i veprës penale dhe është shkel parimi "in dubio pro reo", se mëdyshjet të cilat ekzistojnë lidhur me faktet vendimtare

ato interpretohen në favor të akuzuarit. Gjykata me asnjë fakt vendimtare nuk ka provuar se i akuzuari R.K., të ketë shpërndarë personave tjerë narkotik.

Në të dy ankesat e paraqitura të mbrojtësve të akuzuarve pretendohet se të dy të akuzuarit janë përdorues të narkotikut dhe nuk ka ekzistuar qëllimi i shitjes, marrëveshja paraprake dhe ku është gjetur narkotiku. Nga provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar fakti i elementeve të veprës penale për të cilat të akuzuarit janë shpallur fajtor.

Mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre pretendojnë se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve dhe gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, e kjo sidomos është potencuar në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.M., pretendohet se e ka strehuar bashkë të akuzuarin, nga pakujdesia dhe është vënë në lajthim për arsye se ka qenë i varur nga përdorimi i substancave narkotike. Edhe vendimi mbi dënimin është i ashpër se i akuzuari F.M., është madhor i ri dhe përgjegjësia penale nuk mund të jetë e njëjtë si të rriturit dhe nuk ka marrë parasysh faktin si denoncuese e kësaj vepre penale është nëna e të akuzuarit.

Gjykata e Apelit, në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 duke vepruar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, e edhe sipas detyrës zyrtare, vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota se të akuzuarit F.M. e R.K., janë kryes të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe kanë pasur për qëllim shitjen dhe shpërndarjen e substancës narkotike të llojit “marihuan”, e cila është gjetur në podrumin e adaptuar, të prindërve të akuzuarit F.M.. Kjo mbështetet në faktet se të dy të akuzuarit kanë vepruar në bashkëveprim, së pari ata kanë blerë 80 qese të vogla të najlonit, të cilat i kanë mbushur me narkotik dhe gjykata ka nxjerr konkludim të drejtë se qëllimi i të akuzuarve ka qenë shitja dhe shpërndarja e narkotikut të llojit “marihuan”, në sasi të përgjithshme prej 66.36gr. dhe në këto 80 qese të cilat ishin blerë për vendosjen e narkotikut për përgatitjen për shitje dhe shpërndarje në 18 qese është vendosur narkotiku, me qëllim që ajo të shitet dhe të shpërndahet te përdoruesit tjerë. Nga kjo del qartë se gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktin vendimtar se qëllimi i të akuzuarve ka qenë shitja dhe shpërndarja e narkotikëve e këto mbështeten edhe nga ekspertiza e ekzaminimit të AKF, me nr.2017-373/2017-3357, të dt.06.03.2018, si dhe procesverbali i bastisjes. Nga ajo që u tha më lartë rezulton se pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve, janë të pa qëndrueshme dhe aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet e pretenduara ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë, e të cilat janë paraqitur në ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, janë të pabazuara, gjykata e shkallës së parë, drejt ka vërtetuar se me dt.28.10.2017, të akuzuarit kanë mbushur qese të vogla të llojit “marihuan” dhe me dt.03.11.2017, në podrumin e adaptuar të prindërve të akuzuarit F.M., të akuzuarit kanë mbajtur të fshehur dy qese të najlonit të mbushura narkotik të llojit “marihuan”, njëra me prej 52.51gr kurse tjetra në peshë prej 13.85gr dhe një cigare në peshë prej 0.30gr. të gjitha të llojit “marihuan”, dhe gjykata drejt ka vërtetuar se pesha e përgjithshme ka qenë prej 66.36gr. e të cilat janë paketuara në qese të vogla të najlonit. Gjykata drejt ka vërtetuar se këto paketime prej 18 qeseve në të cilat ka qenë e vendosur substanca narkotike e llojit “marihuan”, ka qenë me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes nga ana e të akuzuarit. Kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, është e pranueshme dhe për Gjykatën e Apelit.

Pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarve nga neni 385 par.1 të KPP, është e pabazuar, gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar ligjin penal se të akuzuarit me dt.28.10.2017, kanë mbushur qese të vogla të llojit “marihuan”, dhe me dt.03.11.2017, në

podrumin e adaptuar të prindërve të akuzuarit F., kanë mbajtur të fshehur dy qese të najlonit të mbushura narkotik të llojit “marihuan”, njëra me prej 52.51gr kurse tjetra në peshë prej 13.85gr dhe një cigare në peshë prej 0.30gr. të gjitha të llojit “marihuan”, dhe gjykata drejt ka vërtetuar se pesha e përgjithshme ka qenë prej 66.36gr. e të cilat janë paketuara në qese të vogla të najlonit. Nga kjo rezulton se në veprimet e të akuzuarve ka ekzistuar qëllimi i shtijës dhe shpërndarjes të narkotikut të llojit “marihuan”, në peshë të përgjithshme prej 66.36gr. e nga e cila 18 qese najloni janë mbushur nga ana e të akuzuarve, e me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes dhe në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën ata janë shpallur fajtor dhe gjykata drejt ka aplikuar ligjin penal.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin mbi dënimin, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit janë të bazuara, për arsye se gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat shkojnë në favor të akuzuarve dhe Gjykata e Apelit, rrethanat lehtësuese të cilat i ka gjetur gjykata e shkallës së parë, si gjendjen ekonomike të dobët të akuzuarve, se të akuzuarit janë të moshës së re, i merr si të vërtetuara e duke marrë parasysh se të akuzuarit nuk kanë ra ndesh me ligjin, kjo tregon se sjelljet e tyre të mëparshme kanë qenë në harmoni me dispozitat pozitive ligjore, e duke marrë parasysh peshën e veprës penale se te të akuzuarit është gjetur sasi e vogël e llojit “marihuan”, e cila nuk është shitur dhe shpërndarë dhe nuk janë shkaktuar pasoja të dëmshme në jetën dhe shëndetin e personave tjerë, kjo gjykatë gjen se dënimet e shqiptuara të akuzuarve nuk janë vlerësuar në kuadër të rregullave të përgjithshme mbi matjen e dënimit, të paraparë si në nenin 73 të KPRK, se mungojnë pasojat e përdorimit të narkotikut nga persona tjerë, Gjykata e Apelit, ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe dënimet e shqiptuara me gjobë secilit të akuzuar në shumë prej nga 200(dyqind)Euro, i merr si të vërtetuara, dhe secilit të akuzuar iu shqipton dënime me burgim në kohëzgjatje prej nga 1(një)vit e 6(gjashtë)muaj, e në të cilin dënim të akuzuarve u është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak e paraburgim prej dt.03.11.2017, gjer me dt.22.06.2018 dhe dënimet komulative të shqiptuara janë në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, me bindjes se me dënimet e këtilla të shqiptuara në tërësi do të arrihet, preventiva individuale që të parandalojë të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe preventiva e përgjithshme që ti parandalojë edhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe pritet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë si në nenin 41 të KPRK.

Prandaj, nga arsyet e përshkruara më lartë u deshtë që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve, e në bazë të nenit 403 par.1 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.426/2018, me dt.18.10.2018**

**Procesmbajtësi,**

**Eroll Gashi**

**Anëtarët e Kolegjit,**

**Fillim Skoro**

**Mejreme Memaj**

**Kryetari i Kolegjit,**

**Driton Muharremi**